



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
Sesioni pranveror

**Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi**

Mbledhja nr.09  
Prishtinë, më 23.1.2018, në orën 14:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Arbërie Nagavci, Adem Mikullovc, Fidan Rekaliu, Abdyl Salihu, Nezir Çoçaj dhe Verica Qeraniq

**Munguan:** Mufera Shinik, Valentina Bunjaku-Rexhepi dhe Albulena Balaj-Halimaj.

**Përfaqësues të tjerë:** Rinor Qehaja-EDGUARD dhe përfaqësues të medias.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

**Mbledhjen e kryesoi, Ismajl Kurteshi, kryetar i Komisionit.**

**Në këtë mbledhje u propozua ky**

**Rend i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 16.1.2018;**
- 3. Shqyrtimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2018;**
- 4. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.17/19 të dt. 15.12.2017 për ratifikimin e anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të AKA;**
- 5. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

### **1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

### **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 16.1.2018;**

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 16.1.2018, u miratua pa vërejtje.

### **3. Shqyrtimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2018;**

**Ismajl Kurteshi**, tha se shqyrtimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2018, është bërë në mbledhjen e kaluar, por meqë disa nga anëtarët e Komisionit nuk kanë qenë prezent, u propozua që i njëjti të plotësohet me propozimet për mbikëqyrjen e ligjeve nga ana e anëtarëve tjerë të Komisionit. Në vazhdim, në kuadër të monitorimit të ligjeve, ai propozoi që Komisioni të bëjë monitorimin e Ligjit për sponsorizime në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, që sipas informacioneve nuk ka filluar të implementohet dhe nuk janë bërë rregulloret në fushën e kulturës, andaj duhet ta kemi në planin e punës monitorimin e këtij ligji dhe të formohen grupet e punës. Kurteshi propozoi që në planin e punës të përfshihet edhe mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Trashëgimi Kulturor dhe shtoi se meqë në plan të punës këtë vit kemi Projektligjin për Arsim Parashkollor, do të duhej që miratimi i këtij ligji të prijë me shumë aktivitete dhe vizita edhe në çerdhe.

**Arbërie Nagavci**, propozoi që para se të realizohen këto vizita, të specifikohet qëllimi i vizitës në çështjet që janë me interes, me qëllim që të dalim me përfundime konkrete pas realizimit të këtyre vizitave, si dhe propozoi që në rastet kur të ftohet ministri për raportim për një çështje, paraprakisht ta dërgojë një raport me shkrim.

Sa i përket monitorimit të ligjeve që janë bërë nga ana e Komisionit për Arsim gjatë Legjislaturës së kaluar, Nagavci kërkoi që rekomandimet e dala nga monitorimet të shikohen në mënyrë që të shihet sa po zbatohen ato rekomandime.

Në vijim propozoi që në kuadër të vizitave të realizohet edhe një vizitë në Shqipëri për të mbikëqyrur zbatimin e Marrëveshjes në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë në fushën e arsimit, kulturës dhe sportit.

**Teuta Haxhiu**, tha se në mbledhjen e ardhshme të ftohet ministri i MASHT-it në mënyrë që të diskutohet lidhur me arsimin e lartë, si dhe të diskutohet në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Komisionit nga mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Arsimin Parauniversitar.

Më tej, ajo përmendi shqetësimet lidhur me afatin për regjistrim të studentëve në institucionet private, të cilat ende bëjnë thirrje se studentët mund të regjistrohen.

**Nezir Çoçaj** propozoi që Komisioni të organizojë një tryezë për Arsimin e Lartë, si dhe të organizojë vizita në institucionet publike dhe private të arsimit të lartë. Ai propozoi që të

themelohen grupe punuese për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve në mënyrë që një grup punues të merret me arsimin parashkollor ndërsa grupi tjetër të merret me monitorimin e arsimit të lartë.

**Ismajl Kurteshi**, tha se Plani i punës së Komisionit do të plotësohet me propozimet që u dhanë sot nga anëtarët e Komisionit, për ligjet që do t'i mbikëqyrin dhe i njëjti mund të plotësohet edhe në vazhdim me shqyrtimin e çështjeve tjera që mund të vijnë në Komision, dhe propozoi që i njëjti të votohet.

Plani i punës së Komisionit për vitin 2018, u miratua nga të gjithë anëtarët e Komisionit.

#### **4. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.17/19 të dt. 15.12.2017 për ratifikimin e anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të AKA**

**Ismajl Kurteshi**, tha se bazuar në Përfundimin e Kryesisë së Kuvendit nr.06/516 /d të datës 26.12.201 dhe Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.17/19 të dt. 15.12.2017 për ratifikimin e anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë Kosovare të Akreditimit, ngarkohet Komisioni të shqyrtojë këtë vendim dhe të rekomandojë për Kuvend.

Në vijim ai lexoi emrat e propozuar nga Ministria e Arsimit për anëtarë të Këshillit Shtetëror të Cilësisë që janë : Gazmend Luboteni, Rozafa Koliqi-Lila, Berim Ramosaj, Arben Qirezi, Dukagjin Zeka, Ilir Doçi si dhe tre anëtarë ndërkombëtarë.

**Arbërie Nagavci**, në diskutimin e saj shprehi pakënaqësitë për shkarkimin e bordit të kaluar nga ana e kryeministrit, pa ndonjë shpjegim, arsye apo raport të vlerësimit për punën e tij.

Sa i përket emrave të propozuar për bord të ri, tha se ka vërejtje në aspektin e kuotës gjinore, tha se respekton gradat shkencore dhe fushëveprimtarinë e tyre, por të gjithë vijnë nga fushëveprimtaritë e tjera dhe jo nga arsimit, vetëm një prej tyre është njohës i arsimit, dhe mendoj që bashkë me CV-të e tyre do të duhej të vinte një shkresë përmes së cilës këta anëtarë do të duhej të arsyetonin këtë punë.

**Nezir Çocaj**, tha se përbërja e bordit të ri nuk përkon me fushën e arsimit, dhe se kjo Agjenci nuk duhet të përbëhet nga grada shkencore të drejtimeve tjera, por nga njerëz që merren me fushën e arsimit. Këshilli Shtetëror i Cilësisë do të duhej të ishte profesional e jo të ngarkohet me njerëz që nuk janë të fushës së arsimit, si farmacistë apo ekonomistë, dhe tha se nuk pajtohet me këtë propozim duke pasur parasysh problemet në arsimin e lartë.

**Adem Mikullovc**, gjithashtu shprehi pakënaqësitë e tij duke thënë se bordi ka përfaqësues që nuk janë profesionistë. Ai tha se kjo po na kushton, pasi në borde po emërohen persona që nuk janë të aftë dhe që nuk janë profesionistë.

**Teuta Haxhiu**, tha se Këshilli Shtetëror i Cilësisë është padyshim një prej institucioneve kryesore të arsimit të lartë. Ajo pati vërejtje në përfaqësimin gjinor, ndërsa propozoi që për shkak të rëndësisë që ka, të miratohet kjo listë me emrat e propozuar, ndërsa propozoi që bordi aktual

në afat brenda prej tre muajve të sjellë një raport për punën e bërë nga bordi i shkarkuar, për të gjeturat e ish- anëtarëve të shkarkuar se çfarë ka bërë bordi i kaluar me cilësinë e arsimit.

**Arbërie Nagavci**, tha se nuk pajtohet me këtë propozim, meqenëse bordi i ri duhet të merret me punën e tyre dhe jo me hulumtimin e punës e bordit të shkarkuar.

**Fidan Rekalju**, tha se paraprakisht ministri do të duhej të jep arsyen e shkarkimit të bordit të kaluar si dhe një arsyetim në lidhje me atë se pse këta anëtarë duhet votuar.

**Abdyl Salihu**, tha se duke pasur parasysh rëndësinë e Këshillit, pajtohet që të procedohen rekomandimi për emërimin e tyre në Kuvend.

**Ismajl Kurteshi**, tha se nga diskutimet e anëtarëve të Komisionit, shumica e anëtarëve ishin të pajtimit që përbërja e këtij bordi nuk është e profilizuar në fushën e arsimit, dhe u pajtua që Kryesisë së Kuvendit t'i rekomandojë për ratifikim emrat e propozuar për anëtarë të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë Kosovare e Akreditimit, por me këto vërejtje.

Komisioni pas diskutimeve me 6 vota për dhe 2 abstenime nxori këtë:

### **R e k o m a n d i m**

I Rekomandohet Kuvendit të Kosovës të bëjë ratifikimin e 9 (nëntë) anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë.

#### **5. Të ndryshme.**

Ismajl Kurteshi, propozoi që në mbledhjen e radhës të ftohet ministri i MASHT-it, Shyqiri Bytyçi për të shqyrtuar Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjen Ndërkombëtare në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës (MASHT) dhe Stitching SPARK-ut të Holandës (SPARK) për mbështetjen e Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit Mitrovica si dhe të raportoni në lidhje me gjendjen në Arsimin e Lartë (me theks të veçantë rreth nismës për vlerësimin e qëndrueshmërisë së Universiteteve Publike, si dhe çështjes së regjistrimit të studentëve në institucionet private të arsimit të lartë).

Mbledhja përfundoi në orën 15:15.

*E përgatiti:*

*Stafi mbështetës i Komisionit*

Kryetari i Komisionit,

-----  
Ismajl Kurteshi